

RELACION

PËR

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR RATIFIKIMIN
E MARRËVESHJES SË GRANTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “HEKURUDHAT
SHQIPTARE - REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE
TIRANË – DURRËS DHE NDËRTIMI I LINJËS HEKURUDHORE
PËR NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS”, NË
KUADËR TË GRANTIT TË INVESTIMIT NGA FONDI I
PËRBASHKËT EVROPIAN I BALLKANIT PERËNDIMOR”**

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës” nëpërmjet një granti në shumën 35 435 000 euro, i cili akordohet nga Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor.

Projekti i rehabilitimit të linjës hekurudhore Tiranë – Durrës dhe ndërtimi i linjës së re hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës ka për qëllim, përveç ndërtimit të një linje të re për në aeroportin e Tiranës, edhe modernizimin e linjës ekzistuese Tiranë – Durrës, nëpërmjet përmirësimit të karakteristikave gjeometrike dhe operacionale të vijës hekurudhore në përputhje me standardet e BE-së, të përcaktuara nga direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian, për të rritur efikasitetin dhe sigurinë e transportit hekurudhor të mallrave dhe udhëtarëve ndërmjet Tiranës, Durrësit e Aeroportit të Rinasit dhe, në të njëjtën kohë, për të kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin ekonomik të zonës ekonomike të rajonit të Durrësit, Tiranës dhe të gjithë vendit.

Ky qëllim do të realizohet nëpërmjet objektivit të përgjithshëm dhe objektivave kryesorë:

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të zhvillojë transportin hekurudhor ndërmjet Durrësit dhe Tiranës, duke përmirësuar infrastrukturën dhe operacionet hekurudhore, garantuar sigurinë e lëvizjes dhe ndërveprimin, si dhe duke ndërtuar një lidhje të re hekurudhore për në Aeroportin e Rinasit, që është dhe i vetmi aeroport ndërkombëtar i vendit. Përveç kësaj, një objektiv paralel i

projektit është ndërfutja e një regjimi miqësor me mjedisin, zvogëlimi i bllokimeve të trafikut rrugor ndërmjet Durrësit, Tiranës dhe aeroportit të Rinasit si dhe kontributi në reduktimin e ndotjes së ajrit nga trafiku rrugor në rajonin Durrës - Tiranë.

Objektivat kryesorë në drejtim të rezultateve lidhen me rehabilitimin e linjës ekzistuese hekurudhore nga stacioni qendror hekurudhor Durrës deri në vendndodhjen e ardhshme të Terminalit të Transportit Publik të Tiranës (PTT) për një gjatësi 34.2 km dhe, gjithashtu, për të ndërtuar një linjë të re hekurudhore që lidh linjën kryesore me Aeroportin e Rinasit (gjatësi 4.7 km), duke përfshirë dhe degëzimet shtesë 950m dhe 800m, respektivisht, për të lidhur linjën e re me Terminalin e Transportit Publik Tiranë PTT si dhe me qytetin e Durrësit. Projekti parashikon, gjithashtu, ndërtimin e një terminali hekurudhor në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA), si dhe instalimin e një sistemi të ri sinjalizues e telekomunikacioni, të integruar në sistemin e linjës hekurudhore Durrës - Tiranë - Rinas.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektligji mbështetet në VKM-në nr.348, datë 11.5.2016, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020”, (Fl. zyrtare 86) për përmbushjen e objektivit nr.8, për zhvillimin e transportit hekurudhor dhe intermodal për rehabilitimin e linjës hekurudhore Tiranë – Durrës, si dhe përmirësimin e infrastrukturës hekurudhore nëpërmjet rehabilitimit të linjave ekzistuese dhe ndërtimit të linjave të reja të ndërlidhjes rajonale, sikurse zgjerimi i TEN-T për hekurudhat e rrjetit bazë të Ballkanit Perëndimor: Route 2 – Podgoricë – Durrës / Tiranë. Mbështetet gjithashtu në VKM-në nr.811, datë 16.11.2016, “Për miratimin e strategjisë sektoriale të transportit dhe planit të veprimit 2016-2020 për zhvillimin e transportit hekurudhor me veprimin prioritar hekurudhor nr.6, “Për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore Durrës – Tiranë dhe lidhjes së re me Aeroportin e Rinasit”. Projekti, po ashtu, mbështetet në ligjin nr.142/2016, “Kodi Hekurudhor i RSH-së”, i cili është i përafshuar me *acquis* të BE-së.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projekti përmbush objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim SKZHI 2015 - 2020 për modernizimin e hekurudhave. Projekti, që pritet të realizohet nëpërmjet financimit që do të sigurohet me anë të marrëveshjes në fjalë, është ndër prioritetet parësore për rrjetin hekurudhor, sipas dokumentit strategjik 2016 – 2020 të planit të veprimeve prioritare të sektorit hekurudhor.

Ky projekt ishte një nga tri projektet fituese në Samititin e Parisit, të mbajtur në korrik 2016, ku konkurronin për fonde të BE/WBIF (Fondi i Investimit për Ballkanin Perëndimor) projekte nga 6 vendet e Ballkanit Perëndimor. Në këtë kuadër, akordohet me anë të marrëveshjes, që i bashkëngjitet këtij projektakti, granti në shumën 35 435 000 euro.

Për realizimin e këtij projekti, më 29 dhjetor 2016 është nënshkruar marrëveshja e huas, në shumën 36 870 000 euro, për financimin e pjesshëm të projektit në fjalë, e cila është ratifikuar me ligjin nr.29/2017, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”.

Granti i WBIF-së do të plotësojë financimin e nevojshëm për projektin, duke synuar bashkëfinancimin deri në 50 për qind të kostove kapitale të tij, financimin e mbikëqyrjes së punimeve dhe mbështetjen për zbatimin e projektit.

Kjo marrëveshje synon zbatimin e projektit të detajuar për rehabilitimin e hekurudhës Durrës - Tiranë dhe ndërtimin e linjës së re hekurudhore me Aeroportin e Rinasit, hartuar në bazë të marrëveshjes së grantit, datë 13 mars 2015, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe BERZH-it, si administrator i fondeve grant të siguruar nga qeveri të ndryshme nën Fondin e Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor (EWBJF).

Projekti parashikohet të përfundojë deri më 31.12.2020.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti i propozuar është në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Në zbatim të shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 121, të Kushtetutës, marrëveshja, e cila është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.110, datë 23.2.2018, si dhe është nënshkruar ndërmjet palëve më 9.5.2018, do të hyjë në fuqi pas ratifikimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk përafron ndonjë akt ligjor të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji i propozuar ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë – Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, teksti i së cilës i bashkëlidhet projektligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e projektligjit ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe shoqëria “Hekurudha Shqiptare”, sh.a.

Zbatimi i projektit do të bëhet nga “Hekurudha Shqiptare”, sh.a., në cilësinë e njësisë së projektit, dhe do të mbështetet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar si rezultat i bashkëpunimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Kostoja totale e projektit vlerësohet në masën 90.45 milionë euro, e detajuar sipas komponentëve dhe sipas burimeve të financimit në tabelën më poshtë.

Kostot e projektit dhe burimi i financimit (EURm)	BERZH Hua	BERZH Grant	EU/WBIF Grant	Qeveria shqiptare	TOTALI
Punime civile (Përfshirë kontingjencën)	36.87		32.935		69.8
Projekti i detajuar & dokumentet e tenderit			1.215		1.215
Mbikëqyrja e punimeve			1.5		1.5
Mbështetja për implementimin			1		1
Forcimi i kapaciteteve Institucionale		0.87			0.87
Shpronësimi i tokave				1	1
TVSH				15.06	15.06
Totali	36.87	0.87	36.65	16.06	90.45

Granti, në shumën prej 35 435 000 eurosh, që do të akordohet nga BERZH-i nëpërmjet marrëveshjes në fjalë, do të përdoret për financimin e punimeve për rehabilitim të linjës ekzistuese dhe ndërtimin e linjës së re, në kuadër të projektit, shërbimeve të mbikëqyrjes së punimeve si dhe mbështetjes për zbatimin e projektit, ndërkohë, siç sqarohet edhe në seksionin III, projekti i detajuar është financuar nëpërmjet një granti të akorduar më parë (viti 2015) nga WBIF/EWBJF, në vlerën 1 215 000 euro.

Projekti është pjesë e parashikimeve buxhetore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për periudhën përkatëse të realizimit, konkretisht në programin “Transporti hekurudhor”.

KËSHILLI I MINISTRAVE